



Durres 09.01.2020

Pershendetje:

Ne lidhje me ndryshimet e fundit ligjore, marre shkas dhe nga pyetje te bera, ne ligjin e procedurave eshte shfuqizuar neni 55 qe ben fjale per **Faturat tatimore, të përgatitura nga blerësi.**

Ky shfuqizim hyn ne fuqi sipas afateve qe prcaktohen ne ligjin **Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.**

Ky i fundit eshte miratuar ne Parlament por akoma nuk eshte botuar ne Fletoren Zyrtare, ndonese ne faqen e Kuvendit eshte lehtesisht e aksesueshme.

Mbi kete baze **Faturat tatimore, të përgatitura nga blerësi**, sipas ligjit te procedurave shfuqizohet me 1 Shtator 2020 dhe pas kesaj date hyn ne fuqi neni 7 pika 2 germa a) e ligjit **Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.**

E thene ndryshe rregulli per **Faturat tatimore, të përgatitura nga blerësi** (ose autofaturen ne zhargonin e perditeshem), nuk eshte prishur por eshte kaluar nga njeri ligj ne tjetrin.

Me poshte kuadri ligjor per sa me siper.

Nr. 9920, datë 19.5.2008
PËR PROCEDURAT TATIMORE NË RSH

Neni 53

Faturat tatimore, të përgatitura nga blerësi

1. Në rastin e shitjeve nga individët, që nuk kanë cilësinë e tregtarit, fatura përgatitet nga blerësi, ushtrues i veprimtarisë tregtare, me kusht që dokumenti të përmbajë përshkrimet dhe të dhënat e parashikuara në këtë ligj dhe vërtetohet nga furnizuesi. Blerësi, për çdo rast të tillë, shënon në faturë edhe numrin e tij të identifikimit.

2. Ministri i Financave, me udhëzim, mund të parashikojë forma të posaçme dokumentesh, që zëvendësojnë faturën tatimore.

Ligji. 83/2019 datë 18.12.2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008,
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË RSH”**

Neni 5

Nenet 49, 50, 51, 52, **53**, 54, 55 dhe 56 **shfuqizohen**.

Neni 32 Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Përjashtimisht përcaktimeve të pikës 1, të këtij neni, nenet 1, 2, 3, 4, **5**, 6, 7, 8, 12, 13, 14, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29 dhe 30 **fillojnë efektet respektivisht në të njëjtën datë** me afatet specifike të përcaktuara në legjislacionin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Ligji 87/2019 date 18.12.2019

Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit

KREU III LËSHIMI I FATURËS

Neni 7

Rregulla të veçanta për lëshimin e faturës

1. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura, janë të detyruar të lëshojnë një faturë edhe për çdo pagesë të bërë përpara kryerjes së furnizimit të mallrave ose përpara përfundimit të furnizimit të shërbimeve.

2. Përveç detyrimit të lëshimit të faturave për çdo furnizim të mallrave ose ofrimit të shërbimeve, tatimpaguesit, subjekte të TVSH-së ose të tatimit mbi fitimin, apo të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për biznesin e vogël, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, **detyrohen të lëshojnë faturë si pranues të mallrave apo shërbimeve të furnizuara kur:**

a) blejnë mallra ose shërbime nga individë që nuk kanë cilësinë e tregtarit dhe që nuk janë të regjistruar në administratën tatimore si tatimpagues që lëshojnë fatura, me kusht që fatura të përmbajë informacionin dhe të dhënat e parashikuara në këtë ligj;

b) në kuadër të veprimtarisë ekonomike të tyre, blejnë shërbime të furnizuara nga një person i tatueshëm, që nuk është i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç nëse ky person i tatueshëm, shitësi nga jashtë, lëshon një faturë elektronike, në përputhje me specifikimet teknike të përfshira në Standardet Shqiptare (SSH), siç janë

publikuar nga institucioni përgjegjës për standardizimin, që shkëmbehet nëpërmjet platformës qendrore të faturave, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji;

c) blejnë mallra nga prodhuesit bujqësorë, që janë subjekte të skemës së kompensimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

3. Ministri përgjegjës për financat, përcakton me udhëzim zbatimin e këtij neni në lidhje me procedurën e vetëfaturimit, në rastin e blerjes së shërbimeve nga tatimpaguesit jashtë vendit, si dhe procedurën për shkëmbimin e faturave elektronike nëpërmjet platformës qendrore të faturave, për shitësit dhe lëshuesit e faturave nga jashtë vendit.

Neni 48

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Përjashtimisht pikës 1, të këtij neni, në varësi të llojit të transaksionit, ky ligj i fillon efektet sipas grafikut të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të kësaj pike.

a) Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatim fitimit me të ardhura vjetore mbi 8 milionë lekë, efektet e këtij ligji **fillojnë më 1 shtator 2020.**

b) Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatim të thjeshtuar mbi fitimin me të ardhura vjetore mbi 2 milionë lekë, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021.

c) Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me të ardhura vjetore deri në 2 milionë lekë, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021.

ç) Për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021.

d) Për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 korrik 2021.